REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr.9207 Prot                                        Shkodër, më 21.04.2026

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion

**KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

**"Per nje shtese ne VKB nr 84 date 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"**

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

Nr. 9207/1 Prot Shkodër, më 21 04 / 2026

**P/VENDIM**

**Nr.______, datë____.____.2026**

**"PER NJE SHTESE NE VKB NR 84 DATE 18.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR", I NDRYSHUAR".**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____.____.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; të nenit 45 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar ; Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; ligjit nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" të ndryshuar; VKM nr 38 dt 19.01.2022 "Për miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet KM përfaqësuar nga MIE dhe Konfederatës Zvicerane , të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Cështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e "Projektit të bashkive me energji inteligjente ( SEMP)." Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 1 dt 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" të ndryshuar; Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave nr 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026", VKB nr 84, datë 18.12.2025"Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër",i ndryshuar , Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 23029/1 prot dt 27.12.2022 "Akordim fondesh në kuadër të projekteve me financim të huaj " si dhe relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme nr .............. dt ................

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtesës së planit në Buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr 84 dt 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar, në programimin AD141 "Planifikimi dhe kontrolli i territorit dhe Mjedisit " për projektin : Investime në Kuadër të Projektit Bashki të Zgjuara Energjie , në vlerën 10,126,800 lekë sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 23029/1 prot dt 27.12.2022 "Akordim fondesh në kuadër të projekteve me financim të huaj " –Fond MFE për pagesë bashkëfinancim për projektet "Bashki me shfrytëzim inteligjent të Energjisë ( SEMP) ( SECO) sipas detajimit më poshtë:

| Nr | Kap | Programi | Emërtimi | Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara | Institucioni |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1 | AD141 "Planifikimi dhe Kontrolli I territorit dhe Mjedisit | **P.AD141.Q4.O1.A3/1;** Investime ne kuader te projektit Bashki te zgjuara energjie.( Shtesë) **A1.** Investime/ zbatim ne kuader te projektit Bashki te zgjuara energjie ( rruga Isuf Sokoli) | 9,998,409 | Bashkia Shkodër |
| 2 | | | **A3** Mbikqyrje e Investimit Bashki te Zgjuara Energjie ( Rr Isuf Sokoli) | 110,000 | Bashkia Shkodër |
| 3 | | | **A4.** Kolaudim Investimi Bashki te Zgjuara Energji ( rr Isuf Sokoli) | 18,391 | Bashkia Shkodër |
| | | **TOTALI LEKE** | | **10,126,800** | |

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
3.Ky vendim hyn sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar.

**KRYETAR**

**BENET BECI**

ZV/KRYETAR

__________________________

DREJTORIA E PERGJITHESHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

__________________________

DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

__________________________

DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

ELVIN BRAHIMI

DREJTORIA E ANALIZËS DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

__________________________

DREJTORIA E FINANCËS

__________________________

DREJTORIA E PERGJITHESHME JURIDIKE, BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE MBESHTETESE

__________________________

DREJTORIA E JURIDIKE

__________________________

R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME**

Nr._____ Prot                                                            Shkodër, më ____.____.2026

# R E L A C I O N

**“Per nje shtese ne VKB nr 84 date 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar“**

Ashtu sic edhe jeni në dijeni Bashkia Shkodër është përfituese dhe nënshkruese memorandumit të projektit “Bashki me shfrytëzim inteligjent energjie” (SEMP), miratuar me VKM nr 38 dt 19.01.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet KM përfaqësuar nga MIE dhe Konfederatës Zvicerane , të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Cështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të bashkive me energji inteligjente ( SEMP).”
Nëpërmjet këtij projekti Bashkia Shkodër përfitoi fondin prej 64,661,667 leke , fond i cili u përdor për Permiresimin e Ndricimit Rrugor për 17 akse rrugore në qytetin e Shkodrës me një gjatësi prej 9 km rrugë të ndricuara LED.

Bashkia Shkodër në kuadër të zbatimit të këtij projekti bashkëfinancoi me një fond nga buxheti i saj për Realizimin e Projekteve 12 projekte , sepse 5 projektet e tjera janë realizuar nga specialistët e bashkisë. Meqënëse ky ishte një projekt me bashkëfinancim duke perfshire si fondin e projektit pra ne forme “cash” po ashtu edhe “in-kind” Bashkia ju drejtua me shkresën nr 16576 prot dt 04.11.2022 , Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës ( SASPAK) që të na mundësonte rimbursimin e këtij bashkëfinancimi.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e saj nr 23029/1 prot dt 27.12.2022 ka miratuar këtë kërkesë duke miratuar “Fond për pagesë bashkëfinancimi për projektin “Bashki me shfrytëzim inteligjent energjie (SEMP)” ne vlerën 10.126.800 leke.

Aktualisht jemi në përmbyllje të Projektit Bashki me Shfrytëzim Inteligjent Energjie , për këtë arësye kërkojme sot që këtë fond ta përdorim përsëri për të njëjtin qëllim:
Investime në kuadër të projektit bashki të Zgjuara Energjie (për të Përmirësuar i ndricimin rrugor “Rruga Isuf Sokoli”) bashkëlidhur Fisha e projektit, duke percaktuar edhe fondin per Mbikqyrje dhe Kolaudim per kete investim.
Ky fond do të përfshihet në në programimin AD141 “Planifikimi dhe kontrolli I territorit dhe Mjedisit “ për projektin : Investime në Kuadër të Projektit Bashki të Zgjuara Energjie.

Për sa më sipër :

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; të nenit 45 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar ; Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; ligjit nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" të ndryshuar; VKM nr 38 dt 19.01.2022 "Për miratimin e marrëveshjes së projektit ndërmjet KM përfaqësuar nga MIE dhe Konfederatës Zvicerane , të përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Cështjet Ekonomike, mbi dhënien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e "Projektit të bashkive me energji inteligjente ( SEMP)."Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 1 dt 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" të ndryshuar; Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave nr 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026", VKB nr 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër",i ndryshuar , Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 23029/1 prot dt 27.12.2022 "Akordim fondesh në kuadër të projekteve me financim të huaj "

Kërkoj Miratimin e shtesës në buxhet si më poshtë :

| **Nr** | **Kap** | **Programi** | **Emërtimi** | **Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara** | **Institucioni** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1 | **AD141 "Planifikimi dhe Kontrolli I territorit dhe Mjedisit** | **P.AD141.Q4.O1.A3/1;** Investime ne kuader te projektit Bashki te zgjuara energjie.( Shtesë) **A1.** Investime/ zbatim ne kuader te projektit Bashki te zgjuara energjie ( rruga Isuf Sokoli) | 9,998,409 | Bashkia Shkodër |
| 2 | | | **A3** Mbikqyrje e Investimit Bashki te Zgjuara Energjie ( Rr Isuf Sokoli) | 110,000 | Bashkia Shkodër |
| 3 | | | **A4.** Kolaudim Investimi Bashki te Zgjuara Energji ( rr Isuf Sokoli) | 18,391 | Bashkia Shkodër |
| | | **TOTALI LEKE** | | **10,126,800** | |

**Drejtoria e Mjedisit, dhe Energjise se Rinovueshme**
**Aida Shllaku**

**K R Y E T A R**
**Benet BECI**

| Nr 20 | **P.AD141.Q4.O1.A3/1** Investime ne kuader te projektit Bashki te Zgjuara Energjie. ( shtesë) | **Progami AD141: Planifikimi dhe Kontrolli i Territorit dhe Mjedisi** |
|---|---|---|

**Përshkrimi i shkurtër i projektita) Përshkrimi i shkurtër i projektit :**

Projekti "Bashki të Zgjuara Energjie" (PBZE) synon të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, të zvogëlojë konsumin e energjisë, të promovojë burimet e energjisë së rinovueshme duke promovouar përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin.

Projekti konsiston në vlerësimin e kunsumit energjetik ne ndriçimin publik (si një nga sektorët me konsum më të madh të energjisë elektrike) dhe dhënien e zgjidhjeve eficente të të përmiërsimit të situatës energjitike duke përdorur teknologjinë ekologjike, në reduktim maksimal konsumit aktual dhe duke ndikuar ndjeshëm në uljen e kostos së ndriçimit si dhe duke ndikuar indirekt ne uljen e përgjithshme të $CO_2$, në atmosfere.
Ky projekt nisi me iniciativën e Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO), cili përmes një mekanizmi seleksionimi, përzgjodhi Bashkinë Shkodër si një ndër katër bashkitë fituese për implementimin e këtij projekti.

Nëpërmjet këtij projekti Bashkia Shkodër përfitoi fondin prej 64.661.667 leke , fond i cili u përdor për Permiresimin e Ndricimit Rrugor për 17 akse rrugore në qytetin e Shkodrës me një gjatësi prej 9 km rrugë të ndricuara LED.
Në kuadër të zbatimit të këtij projekti Bashkia bashkëfinancoi me një fond nga buxheti i saj për Realizimin e Projekteve 12 projekte , sepse 5 projektet e tjera janë realizuar nga specialistët e bashkisë. Meqënëse ky ishte një projekt me bashkëfinancim , Bashkia ju drejtua me një shkresë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës ( SASPAK) që të na mundësonte rimbursimin e këtij bashkëfinancimi.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e saj nr 23029/1 prot dt 27.12.2022 ka miratuar këtë kërkesë duke miratuar "Fond për pagesë bashkëfinancimi për projektin "Bashki me shfrytëzim inteligjent energjie (SEMP)" ne vlerën 10.126.800 leke.

Fond të cilin do e përdorë për të realizuar investimin : Investime ne kuader te projektit Bashki te Zgjuara Energjie duke bere Përmirësim I Ndricimit rrugor Rr "Isuf Sokoli" si edhe Mbikqyrje dhe Kolaudim.

**i. Situata**

Ndricimi ne rrugen e propozuar nuk permbush kriteret per nje ndricim eficient i cili te ndikoje ne permiresimin e situates energjetike , pra te ofroje kursim energjie si edhe te ndikoje ne uljen e pergjitheshme te CO2 ne atmosfere.

Nderhyrja e propozuar ndikon direkt ne permiresimin e kesaj situate.

Me poshte jepen te dhenat mbi keto projekte: ne rrugen Isuf Sokoli do te zevendesohen 43 shtylla ndricimi me 43 ndricues LED projektor 80W, 4000K, duke bere investim edhe ne linjen e ndricimit me kabell ne nje gjatesi 1350 ml. Shtylla me lartesi 9m.






**ii. Synimi i projektit**

Synimi kryesor i tij është që të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, duke ulur konsumin vjetor të energjisë, duke sjellë një situatë me të mirë energjitike, kosto më të ulët të ndriçimit publik sidhe përmirësimin e e këtij shërbimi.

Me anë të këtij projekti synohet të arrihet një ndriçim standart, duke garantuar uniformitet, komfort dhe jetëgjatësi me të madhe të ndriçimit.

Me kursimin e energjisë indirekt synohet të ndikohet tek ulja emetimeve të gazeve serë.

Me anë të këtij projekti synohet që të krijohet një qasje e re në raport me konsumin energjitik ne ndriçimin publik duke ndryshuar sjellje ne raport me eficensen energjitike duke hapur një kapitull të ri në menaxhimin e energjisë ne sektorin publik.

Gjithashtu projekti eshte pjese e zbatimit te Planit të Efiçencës së Energjisë për Bashkinë Shkodër, si një dokument që do të garantojë vijimësinë e projeteve/ investimeve në funksion të efiçencës së energjisë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Auditimi energjitik i ndriçimit publik në rrugët e perzgjedhura
- Përzgjedhja dhe hartimi i projekteve teknike për zbatimin e tyre.
- Zbatimi i projekteve sipas rradhës së dakortësuar
- Zbatimi i Planit të Efiçencës së Energjisë, Bashkia Shkodër.

**b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

- Te përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, duke ulur konsumin vjetor të energjisë, duke sjellë një situatë me të mirë energjitike, kosto më të ulët të ndriçimit publik sidhe përmirësimin e e këtij shërbimi.
- Realizimi i investimeve me periudhë zbatimi shumë të shpejtë ..
- Forcimi i institucioneve kyçe në lidhje me menaxhimin e energjisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë dhe vendim-marrësve në bashki.
- Përgatitja e Programit Shqiptar të Menaxhimit të Energjisë me mundësitë potenciale për tu shtrirë në nivel kombëtar.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë<br>Agjencia për Eficensen e Energjisë<br>Sekretariati Zvicerian i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) | Bashkia Shkodër, SECO, MFE |

**e) Shpenzimet e llogaritura për çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)**

**SHPENZIME VITI 2026 ( LEKE)**

| | | | Nga kjo: | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Kapitale |
| A1 | Investime/ zbatim ne kuader te projektit Bashki te zgjuara energjie. ( rruga Isuf Sokoli) | 9,998,409 | | | | 9,998,409 |
| A2 | Mbikqyrje e Investimit Bashki te Zgjuara Energjie( rr Isuf Sokoli) | 110,000 | | | | 110,000 |
| A3 | Kolaudim Investimi Bashki te Zgjuara Energjie ( Rr Isuf Sokoli) | 18,391 | | | | 18,391 |
| | **Shuma** | **10,126,800** | | | | 10,126,800 |

**f) Periudha e zbatimit**
prill 2026– dhjetor 2026

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**
Drejtoria e Mjedisit dhe Energjise se Rinovueshme

**Institucion Likuidues**: Bashkia Shkodër